

Niveli Sekundar I



1. deri në 3. klasë të nivelit Sekundar I
(9. deri 11. vite shkollore)

Shkolla Sekundare-I është e ndarë në tri nivelet e kërkesave:

Niveli i kërkesave të shkollës Sekundare B
(kërkesat themelore)

Nxënëset dhe nxënësit përgatiten për stazh pune si nxënës me kërkesa bazore- ose themelore. Shkolla Sekundare B zgjat tre vite.

Niveli i kërkesave të shkollës Sekundare E
(kërkesat e zgjëruara)

Nxënëset dhe nxënësit përgatiten për stazh pune si nxënës me kërkesa të ngritura (me ose pa Matur profesionale). Në raste të veçanta është edhe kalimi në Gjimnaz i mujtur. Shkolla Sekundare-Ezgjatë tre vite.

Viti i (11.) i fundit shkollor të Shkollës popullore

Viti i 11. shkollor i merrë aftësitë individuale të nxënësve veçanërisht në konsiderim dhe i përgatit në mënyrë orientuese për jetën punuese profesionale. Aj i përfshin dy profile: Në çerekun e fundit të klasës së 2. të shkollës Sekundare bëhet një bisedë të përcaktimit të gjendjes dhe situatës aktuale. Bëhet marrëveshja e obligueshme mbi qëllimet dhe përcaktohet zgjedhja e profilit profesional për vitin e 11. shkollor.

Përfundimi i obligueshëm i Shkollës popullore

Nxënëset dhe nxënësit në fund të shkollës fillore e fitojnë Certifikatën përfundimtare. Ajo jep informatat mbi suksesin e arritur.

Niveli i kërkesave të shkollës Sekundare P (kërkesat e larta)

Niveli Sek P zgjat dy vite. Nxënëset dhe nxënësit përgatiten për kalim në Gjimnaz. Ky kryhet pas katër viteve me maturitet gjimnazial dhe shërben përgatitjeve për studimet në shkollat e larta.

Përgjegjësia



Shkolla/Mësimdhënësit

Shkolla dhe mësimdhënësat kujdesen për funksionim të rregullt të Shkollës, për klimë të këndëshme mësimore, ndërmjetsimin e dijenisë, bashkëpunim të Shkollës dhe prindërve si dhe qendrave shërbyese/këshillimoret profesionale të Kantonit.

Prindërit

Prindërit janë përgjegjës për edukimin e fëmijëve tyre. Ato e përkrahin dhe nxisin procesin e tyre arsimor. Ato punojnë së bashku me mësimdhënësit dhe shkollën e fëmijëve tyre. Prindërit i udhëzojnë fëmijët e vetë që ti përmbahen rregullave të shkollës së tyre, ti kryejnë detyrat shtëpiake dhe të shkojnë rregullisht në mësim. Pritet nga prindërit që të marrin pjesë domosdo në mbledhje dhe takime informative të Shkollës. Nëse e kërkon situata dhe rethanat, prindërit duhet të kontaktojnë mësimdhënësat me vetëiniciativë.

Nxënëset dhe nxënësit

Nxënëset dhe nxënësit e kanë obligim të arsimohen njëmbëdhjetë vite të Shkollës popullore. Ato i përmbahen udhëzimeve dhe rregullave mbi bashkëjetesën dhe i zbatojnë rregullat e mësimdhënësve dhe udhëheqësve të Shkollës. Përcjellin mësimin pa mungesa.

Informata detajike mbi Shkollë të vendit ju jep udhëheqësia e Shkollës.

Shkolla popullore në pasqyrim




Informata më tutjeshme

Mësimdhënësat dhe udhëheqja e Shkollës
Enti i Shkollës fillore Solothurn

Internet www.vsa.so.ch në disponim:

- Fllajera në gjuhë të ndryshme
- broshyra detajike në gjermanisht



Volksschulamt

St. Urbangasse 73
4509 Solothurn
Telefon 032 627 29 37
vsa@dbk.so.ch
www.vsa.so.ch

Mirësevini

në shkollën popullore të Solothurnit

Shkolla popullore e Kantonit Solothurn ka një detyrë me pretendime të larta, që fëmijëve dhe rinisë të ia përçojë dijenë dhe aftësinë, ti përkrahi në zhvillimin e tyre të personalitetit dhe pavarësisë integrale.

Për ta plotësuar këtë detyrë, Shkolla ka nevojë të përkrahjes së mbarë shoqërisë. Bashkëpunimi i mirë i Shkollës dhe prindërve është me rëndësi për suksesin shkollor dhe zhvillimin e fëmijëve.

Dëshirat e mia më të mira i përcjellin fëmijët dhe rinin në rrugën e tyre të ardhëmerisë shkollore dhe profesionale.

Andreas Walter



Udhëheqësi i Departamentit shkollor



Me rëndësi

të dihet mbi shkollat e Solothurnit

Çdo fëmi ka drejtë dhe obligim të shkojë në Shkollë popullore. Obligimi shkollor gjatë njëmbëdhjetë vite. Viti shkollor fillon në muajin gusht. Oferta shkollore është e njëjtë si për vasha ashtu edhe për çuna.

Shkolla popullore është një detyrë e përbashkët e Kantonit, Komunës dhe e prindërve. Të gjitha shkollat në Kanton janë të udhëhequra.

Për nxënëse dhe nxënës të cilët kanë nevojë për përkrahje plotësuese me mësimin e rregullt, janë në dispozicion ofertat për përkrahje speciale të promovimit.

Faza fillestare



1. dhe 2. Klasë fidanishte
(viti shkollor 1. dhe 2.)

Fidanishta është shkalla e parë e Shollës popullore. Fëmijët hyrin në fidanishte pasi që e arisinë moshën 4-vjeçare. Pas konsultimit, në mënyrë të veçantë me drejtorinë e shkollës, prindërit vendosin nëse fëmija, duhet të shkojë në shkollë një vit më vonë. Regjistrimi i mëhershëm është i përjashtuar.

Fidanishtë (çerdha e fëmijëve) fëmijët mësojnë duke luajtur

- zgjerimin e përvojave – dhe fushave jetësore
- të bëhen të pavarur
- të levizin në grupin e moshatarve të vetë
- të kontribuojnë vetë diçka për Bashkësi

Pas Fidanishtes, fëmijët kalojnë në klasën e parë-1 të shkollës fillore. Kalimi në këtë fazë do përcjellët nga Fidanishta, Shkolla fillore dhe prindërit.

Klasa e 1. dhe 6. e Shkollës fillore
(3. deri në 8. vit shkollor)



Sholla fillore

- zgjat gjashtë vite
- krijon bazën për mësim të orientuar
- nxit dhe përkrah aftësitë individuale mentale, artistike dhe fizike
- mbështet dhe përkrah arsimin e komunitetit
- mbështet dhe përkrah veprimtari të pavarur dhe me përgjegjësi personale

Si gjuhë e parë e huaj do të mësohet në klasën e tretë të shkollës fillore gjuha franceze, si gjuhë e dytë e huaj anglishtja nga klasa e pestë.

Aftësitë në lëndët do të vlerësohen me nota në dëftesë. Kontributat nëpunë/mësim dhe sjelljet sociale do të vlerësohen dhe regjistrohen në dëftesë. Shkolla fillore nuk ngjeh kushtet promovuese. Nxënës do të ngriten automatikisht në klasë më të lartë.

Procesi transferimit-ngritjes në shkollën (shkollën) Sekundare-I është e rregulluar në nivel kantonial.

Rjedhja e karrierave shkollore në një shikim

Kantoni siguron një ofertë shumëlojshme arsimore, në mënyrë që fëmijët dhe rinia të zhvillohen sipas aftësive dhe prirjeve tyre personale. Grafika e poshtëm iu ofron një pasqyrë të tillë.

Për fëmijët dhe rininë me aftësi të kufizuara është në dispozicion, sipasnevojave, një program i veçantë pedagogjik, arsimor.

Schuljahr 16	Tertiärstufe: Berufs- und höhere Fachprüfungen, Höhere Fachschulen, Fachhochschulen, Pädagogische Hochschulen, Universitäten, Eidgenössische Technische Hochschulen, (ETH/EPFL)			Tertiärstufe
Schuljahr 15	Berufsmaturitätsausbildung lehrbegleitend (3 oder 4 Jahre) oder anschliessend an Berufslehre: 1 Jahr Vollzeit bzw. 1½ Jahre Teilzeit	Fachmaturität	Gymnasium	Sekundarstufe II
Schuljahr 14		Fachmittelschule		
Schuljahr 13	Berufliche Grundbildung 2, 3 oder 4 Jahre			
Schuljahr 12	Brückenangebote			
Ende der obligatorischen Schule				
Schuljahr 11	3. Klasse	Sek B + E		Sekundarstufe I
Schuljahr 10	2. Klasse			
Schuljahr 9	1. Klasse		Sek P	
Schuljahr 8	6. Klasse	Primarschule		Primarstufe
Schuljahr 7	5. Klasse			
Schuljahr 6	4. Klasse			
Schuljahr 5	3. Klasse			
Schuljahr 4	2. Klasse	Kindergarten		Primarstufe
Schuljahr 3	1. Klasse			
Schuljahr 2	2. Klasse			
Schuljahr 1	1. Klasse			

Niveli Sekundar I

Sekundare B (kërkesat themelore)
Sekundare E (kërkesat e zgjërura)
Sekundare P (kërkesat e larta)

Sekundarstufe I

Sek B
Sek E
Sek P

Faza fillestare

Kindergarten
Fidanishta
Primarschule
Shkollës fillore